



**REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA LIBRAZHD**

Data 28/07/2026

PROCESVERBAL - Tipi i kontratës - PUNË

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE
TE VEÇANTA PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Riparim i digave ekzistuese te liqeneve akullnajore nr.1 dhe nr.2 Kusar dhe rikonstruksioni i kanalit te Malit Kusar-Fushe Studen-Letem (L=11 km per 900ha) ”

Kodi sipas Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit (FPP): Riparim dhe renovim

VLERA E FONDIT LIMIT: 145 850 130 (Njëqind e dyzet e pesë milionë e tetëqind e pesëdhjetë mijë e njëqind e tridhjetë) leke pa tvsh

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TE KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet te paraqese:

- a. Formularin Permbledhes te Vetedeklarimit, sipas shtojces 8,*
- b. Sigurimin e Ofertes, sipas Shtojces 3;*

Argumentimi: Kriteri (a) eshte vendosur ne baze te nenit 83 të LPP dhe nenit 30 pika 1 te VKM-së Nr.285, datë19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Kriteri (b) bazohet në nenet 76, 77 dhe 82 të LPP si dhe nenit 26 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar

1.1 Pershtatshmeria per te kryer veprimtarine profesionale:

Sipas kriterëve të përgjithshme të përzgjedhjes/kualifikimit pika 1 e kësaj shtojcë (Shtojca 7).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP i ndryshuar, nenin 39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", të ndryshuar si dhe në ligjin Nr. 9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të biznesit", të ndryshuar.

2.1 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.1.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vertetim për xhiron vjetore për vitet financiare **2023, 2024, dhe 2025**, ku vlera e xhiros për 3 (tre) vitet e fundit duhet të jetë jo më e vogël se **vlera e fondit limit që prokurohet.**

2.1.1 Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43 shkronja c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar. Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vendosija e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vertetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën

2.1.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilanci vjetore, për vitet financiare **2023, 2024, dhe 2025**, të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të *ligjit Nr.10 091, datë 05.03.2009*, ku bilanci të dy viteve të njëpasnjeshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është vendosur referuar nenit 43, pika 4 të VKM-së Nr.285 datë 05.03.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar, si dhe bazuar në Nenin 77 pika 3, e LPP nr.162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", si dhe Ligjin nr.10091 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar, Kreu V, neni 41, pika c. i cili parashikon se: "Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në Ligjin nr. 9920 datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, dhe aktet nenligjore në zbatim të tij.

Kërkesa për paraqitjen e bilnaceve është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.1.3 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një dokument që vërteton se ka plotësuar të gjitha **detyrimet e taksave dhe tarifave vendore**, lëshuar nga Pushteti Vendor, **për vitin 2026 ne te gjitha vendet ku ka ushtruar aktivitetin** referuar ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, si dhe sipas Vendimit të Këshillit Bashkiak përkatës ku subjekti ushtron aktivitetin, lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë këtë dokument ne momentin e dorezimit te dokumentave).

Ky kriter do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, që OE i ka shlyer detyrimet e taksave dhe të tarifave vendore për vitin 2023, do të dorëzohet vetëm nga operatori ekonomik i shpallur fitues perpara lidhjes se kontrates.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur bazuar në nenin 76, pika 2 të LPP si dhe në ligjin Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar sipas të cilit operatorët ekonomikë duhet të shlyejnë detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në çdo adresë ku ushtrojnë aktivitet, neni 5, pika c, sipas afateve te miratuara te kryerjes se pagesave te percaktuara nga cdo njesi e qeverisjes vendore, në Ligjin Nr. 9 920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore”, i ndryshuar, neni 3.1/a, b, c dhe neni 40, në ligjin Nr. 131/2015 “Për QKB” i ndryshuar si dhe në Ligjin Nr. 9 723, datë 03.05.2007 “Për QKR”, i ndryshuar.

2.2 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon:

- Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se **50%** e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;
ose
- punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se **200%** e fondit limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Për plotësimin e këtyre kriterëve Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

- a) Në rast se punimet jane kryer me ente publike:** Autoritetiti Kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon:

- i. Kontratën e Sipërmarrjes,*
- ii. Situacionin përfundimtar të objektit dhe situacionet progresive/pjesore*
- iii. Faturat Tatimore sipas legjislacionit tatimor*
- iv. Aktin e Kolaudimit të objektit*
- v. Çertifikatë e marrjes në dorëzim të objektit*
- vi. Formular Vlerësimi nga Investitori sipas shtojcës nr. 9*
- vii. Në rast se kontrata e ngjashme është lidhur nga një bashkim operatorësh ekonomikë duhet të paraqitet edhe kontrata e bashkëpunimit midis tyre.*

b) Në rast se punimet janë kryer në sektorin privat: Autoriteti Kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon:

- i. Kontratën e Sipërmarrjes,*
- ii. Situacionin përfundimtar të objektit*
- iii. Faturat Tatimore sipas legjislacionit tatimor*
- iv. Aktin e Kolaudimit të objektit*
- v. Çertifikatë e marrjes në dorëzim të objektit*
- vi. Formular Vlerësimi nga Investitori sipas shtojcës nr. 9*

Pika 1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat 50 % të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose jo me te vogël se dyfishi i vlerës limit të objektit të prokurimit për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar. Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatorësh, operatori ekonomik ofertues, është kërkuar edhe paraqitja e kontratës së bashkimit të operatoreve shoqeruar me tabelën e ndarjes së punimeve, ku të cilësohen punimet që ka marrë përsiper të kryejë secili anëtar i BOE, mbështetur në parashikimet e nenit 88 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij dokumentacioni AK ka mundësi të njihet me vlerën reale të punimeve të realizuara nga ofertuesi/t, mbi bazën e një kontrate të realizuar si BOE.

2.3.2 **2.3.2** Operatorët ekonomikë duhet të dëshmojnë se disponojnë liçensë profesionale për zbatim punimesh në ndërtim si dhe në liçensë të disponojnë kategoritë e nevojshme për zbatimin e kontratës. Për këtë duhet të paraqesin liçensën përkatëse të shoqërisë, bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr.42, datë 16.01.2008 “*Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së liçensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi*”, i ndryshuar. Liçensa profesionale e operatorit ekonomik lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës duhet të përmbajë kategoritë e mëposhtme:

- **Për punimet e përgjithshme të ndërtimit, operatori ekonomik duhet të disponojë kategoritë e mëposhtme në liçensë:**
 - **Kategoria NP-1** (*Punime gërmimi në tokë*) – **Klasifikimi F**
 - **Kategoria NP-7** (*Ujësjellës, gazsjellës, vajsjellës, vepra kullimi e vaditje*) – **Klasifikimi F**
 - **Kategoria NP-12** (*Punime të inxhinierisë së mjedisit*) – **Klasifikimi F**
- **Për punimet speciale të ndërtimit, operatori ekonomik duhet të disponojë kategoritë e mëposhtme në liçensë:**
 - **Kategoria NS-1** (*Punime për prishjen e ndërtimeve*) – **Klasifikimi D**
 - **Kategoria NS-9** (*Punime strukturorë speciale*) – **Klasifikimi E**
 - **Kategoria NS-18** (*Punime topogjeodezike*) – **Klasifikimi C**
 - **Kategoria NS-20 A** (*Shpime gjeologo-inxhinierike, puse e shpime ne uje*) - **Klasifikimi B**

* *Për Operatorët e huaj të bëhet njehësimi i liçensës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë Ministrisë së Punëve Publike Transportit dhe Telekomunikacionit në plotësimin e liçensave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës.*

* Në rast të bashkimit të operatorëve ekonomikë, Liçensat profesionale duhet t’i paraqesë operatori ekonomik që ka marrë përsipër punimet për të cilat kërkohet Liçensa Profesionale.

Argumentimi : Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, si dhe VKM nr. 42 datë 16.01.2008, të ndryshuar, “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së liçensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi” (lidhja 2, 3 dhe 4).

** Per Operatoret e huaj te behet njehesimi i licenses profesionale qe disponojne nga vendi i origjines prane Ministrise se Puneve Publike Transportit dhe Telekomunikacionit ne plotesimin e liqensave profesionale te kerkuara per ekzekutimin e kontrates.*

** Ne rast te bashkimit te operatoreve ekonomike, Licensat profesionale duhet t'i paraqese operatori ekonomik qe ka marre persiper punimet per te cilat kerkohet Licensa Profesionale.*

2.3.3 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë Çertifikatat ISO, si më poshtë:

- **ISO 9001** (*Për sistemin e menaxhimit të cilësisë*) e përditësuar
- **ISO 14001** (*Për sistemin e menaxhimit të mjedisit*) e përditësuar
- **ISO 39001** (*Per sistemin e menaxhimit te trafikut rrugor*) e përditësuar
- **ISO BS EN 13331-1** (*Per realizimin e punimeve per veshjet e kanaleve dhe skarpatave te ndryshme*) e përditësuar
- **ISO 3834-2** (*Per sistemin e menaxhimit te cilesise ne saldim*) e përditësuar
- **ISO 9606-1** (*Per sistemin e menaxhimit te cilesise te saldimit ne shkrirje*) e përditësuar
- **ISO 1090-1** (*Per sistemin e menaxhimit te produkteve metalike strukturore*) e përditësuar
- **ISO 45001** (*Për sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë*) ose **ekuivalente me të, të njohur nga Standartet Shqipëtare**, e përditësuar

Çertifikatat e mësipërme duhet të jenë të vlefshme në datën e hapjes së ofertave dhe objekti i së cilave duhet të jetë në përputhje me objektin e prokurimit. Nëse çertifikatat janë në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me përkthimin në gjuhën shqipe të noterizuar. Çertifikatat e mësipërme duhet të jenë të lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë çertifikatat e mësipërme sipas natyrës së punimeve që do të marrë përsipër të realizojë, referuar kontratës së bashkëpunimit të nënshkruar.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, si dhe nenit nr. 79 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe bazuar ne nenin 44 pika 1, e VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 i ndryshuar. Për vet natyrën e veçantë, vendndodhjes dhe përmasat e objektit të kontratës që do të prokurohet, është tepër e rendësishme që operatorët si zbatues, të kryejnë veprimtarinë me standardete kërkuara të cilësisë. Sistemi i menaxhimit të cilësië, mjedisit dhe shëndetit dhe sigurisë në punë janë standarte që çdo subjekt juridik apo privat e ka qëllim në arritjen e suksesit. Këto certifikata lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës përsa kohë do të pronohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës. Referuar në nenin 79 të ligjit 162/2020, te ndryshuar, parashikohet se autoriteti kontraktor mund të kërkojë certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë

pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardet për menaxhimin e mjedisit, shëndetit dhe sigurisë në punë.

Duke qenë se përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi është Autoriteti Kontraktor, gëzon të drejtën për t'u garantuar se operatorët ekonomikë pjesëmarrës i plotësojnë kërkesat e cilësisë për punët që do të kryhen, e rrjedhimisht është e drejtë e këtij të fundit t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga organe të pavarura të njohura nga Sistemet e Standardizimit Kombëtar ose Ndërkombëtar".

- Për ISO 9001 - 2015; Kjo çertifikate specifikon kërkesat për një sistem të menaxhimit të cilësisë, ku një operator ekonomik duhet të tregojë aftësinë e tij që vazhdimisht të sigurojë punë/mallra ose shërbime që plotësojnë kërkesat e aplikueshme ligjore dhe rregullatore, si dhe synon të rrisë kënaqësinë e konsumatorit nëpërmjet zbatimit efektiv të sistemit duke përfshirë edhe proceset për përmirësim të vazhdueshëm të sistemit dhe sigurimin e konformitetit të klientit dhe kushtet e aplikueshme ligjore dhe rregullatore si dhe meqënëse Bashkia Selenice si Autoritet Kontraktor kërkon që punimet që do të kryhen të jenë në cilësinë më të lartë është përcaktuar që kandidatët ofertues të jenë të pajisur me këtë standart cilësie.

- Per ISO 14001 – 2015: Eshtë kërkuar që kandidatët ofertues të jenë të pajisur me standartin ISO 14001 – 2015, standart ky që vlerëson sipas përkufizimit të tij përgjegjshmërinë e kompanive ndaj mjedisit. Standardet e Sistemit të Menaxhimit - që vlerësojnë nivelin e sistemit të zhvillimit dhe integritit të përgjegjësive ndaj mjedisit në të gjithë kompaninë. Bashkia Selenice si Autoritet Kontraktor kërkon një menaxhim të aktivitetit përkushtuar parandalimit të ndotjes dhe të përmirësimit të ndikimeve mjedisore.

- Per ISO 45001:2018: Eshtë kërkuar që kandidatët ofertues të jenë të pajisur me standartin ISO 45001:2018, standart ky që përcakton kërkesat minimale të shëndetit në punë dhe praktikën më të mirë të menaxhimit të sigurisë. Ky lloj standarti konsiston në sigurimin e një sistemi shëndetësor optimal dhe menaxhimin e sigurisë në punë. Kjo mund të ndihmojë për të vënë në vend politikën, procedurat dhe kontrollet e nevojshme për çdo lloj biznesi për të arritur kushtet më të mira të mundshme të punës, një linjë me praktikën më të mirë të njohur ndërkombëtare

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të ketë një punësimin mesatar jo më pak se **70 (shtatëdhjetë) punonjës** për periudhën **3 (tre)** muajt e fundit nga data e hapjes së ofertave, ku përfshihen edhe Stafi menaxherial i Drejtuesve Teknik. Për përmbushjen e këtij kushti, operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të deklarojë sipas formës së disponimit të punonjësve në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të shtojcës 8 në DST, dhe në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të paraqesë:

1. Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj për periudhën e mësipërme.
2. Listëpagesat e Kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të konfirmuara nëpërmjet formës elektronike nga organet tatimore për periudhën e mësipërme.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Argumentim: Ky kriter është vendosur në baze të pikës 4, nenit 77, të ligjit nr 162 datë 23.12.220 “Për Prokurimin Publik” dhe nenit 39, Pika 6/ç, të VKM nr 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohej që operatorët ekonomik të deshmojnë që kanë fuqi minimale puntore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Autoriteti kontraktor në përcaktimin e fuqisë puntore të nevojshme për realizimin e kontratës ka bërë një përllogaritje të numrit të punonjësve duke përcaktuar fillimisht orët e punës në bazë të analizës sipas manualit teknik të çmimeve të ndërtimit miratuar me VKM Nr 216 Datë: 13.04.2023” Për Krijimin dhe Funksionimin e Sistemit të Integruar për Informatizimin e Manualit të Çmimeve për Zërat e Punimeve në Ndërtim në këtë kontekst autoriteti kontraktor ka përcaktuar numrin e punonjësve referuar një përllogaritje të saktë të bërë referuar zërave të punimeve për objektin e prokurimit orëve të punës (8 orë në ditë për çdo punonjës) afatit kohor të realizimit të kontratës si dhe shpërndarjes së punës. Në numrin e përcaktuar për fuqinë puntore janë përllogaritur punetoret e kualifikuara. Nga përllogaritja e orëve të punës për çdo zë pune rezultoi se për kryerjen e punimeve sipas grafikut të punimeve duhen **20** punonjës me kohe të plote.

Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë me kohështirje 3 (tre) muajt e fundit tregon besueshmëri për autoritetin që, operatori do të përmbushë kontratën. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit i parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë vërtetimi i lëshuar nga administrata tatimore e shoqëruar me listpagesat me këtë kohështirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve, përvojën e tyre, dhe janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përpiket të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës.

2.3.5 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë stafin kryesor e mbështetës, punonjësit specialistë dhe çertifikimet përkatëse, si më poshtë:

- a) Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë në liçencë të shoqërisë e të punësuar në stafin e tij teknik për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt, të vërtetuar me kontratë noteriale pune (të vlefshme), diplomë përkatëse, CV, libereze pune, si dhe të figurojnë detyrimisht në

listpagesat e shoqërisë (sipas legjislacionit në fuqi) për periudhën e kërkuar në pikën 2.3.7, stafi inxhinierik si më poshtë:

- Minimuni **2 (dy)** **Inxhinier Ndërtimi**
- Minimuni **1 (një)** **Inxhinier Hidroteknik**
- Minimuni **1 (një)** **Inxhinier Agronom**
- Minimuni **2 (dy)** **Inxhinier Gjeodet/ Topograf/ Markshajder**
- Minimuni **1 (një)** **Inxhinier Mjedisi**
- Minimuni **1 (një)** **Inxhinier Mekanik**
- Minimuni **1 (një)** **Inxhinier Gjeolog**
- Minimuni **1 (një)** **Inxhinier për kontrollin e Cilësisë**

Disponimi i stafit inxhinierik do të deklarohet në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 në DST, si dhe *në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit duhet të paraqesë dokumentacionin e kërkuar më lart.*

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

b) Operatori ekonomik, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë punonjës të specializuar/ kualifikuar si më poshtë:

- Teknik ndërtimi – jo më pak se **2 (dy)** punonjës
- Specialist hidraulik – jo më pak se **3 (tre)** punonjës
- Specialist për restaurime guri – jo më pak se **4 (kater)** punonjës
- Specialist karpentier – jo më pak se **3 (tre)** punonjës
- Specialist murator – jo më pak se **3 (tre)** punonjës
- Hekurkthyes – jo më pak se **3 (tre)** punonjës
- Betonues – jo më pak se **3 (tre)** punonjës
- Montator për konstruksione metalike – jo më pak se **2 (dy)** punonjës
- Saldator – jo më pak se **2 (dy)** punonjës

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është bazuar në paragrafin 3 të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenin 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar dhe VKM nr. 514, datë 20.9.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP)”, të rishikuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për Stafin, lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates, specifikimet teknike, raportin teknik dhe volumet e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Numri i stafit kryesor teknik është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat

sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën.

Personeli i mësipërm kërkohet në bazë të vlerësimit të preventivit dhe të grafikut të punimeve.

- c) Operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë **1 (një) mjek** të përgjithshëm, ku për përmbushjen e këtij kushti operatori ekonomik ofertues duhet ta deklarojë në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 në DST, si dhe *në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit*, duhet të paraqesë dokumentacionin: Kontratë të vlefshme pune/ kontratë shërbimi mjeku, Urdhër mjeku, dhe Diplomë.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili prej operatorëve ekonomik pjesëmarrës në bashkim që plotëson kriteret e VKM-së Nr.108, datë 09.02.2011 i ndryshuar me VKM-në Nr.632, datë 15.07.2015, duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (një) mjek të përgjithshëm.

- d) Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë pjesë të stafit të punësuar 1 (një) punonjës që përmbush kriteret për të qenë **“Person përgjegjës për sigurimin teknik dhe shëndetin në punë”** gjatë realizmit të punimeve, sipas kërkesave të ligjit nr. 10 237 date 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M. nr. 312, date 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier” i cili duhet të figurojë në listëpagesa të shoqërisë për periudhën e kërkuar në pikën 2.3.7, ku për përmbushjen e këtij kushti operatori ekonomik ofertues duhet ta deklarojë në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 në DST, si dhe *në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit*, duhet të paraqesë dokumentacionin: kontratë të vlefshme pune, dhe dëshmi të kualifikimit profesional/diploma/çertifikata trajnimi nga një organizëm i akredituar/licencuar /çertifikuar shqiptar ose i huaj.

- e) Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë pjesë të stafit të punësuar 1 (një) specialist ekspert zjarrefikës në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin, i cili duhet të figurojë në listëpagesa të shoqërisë për periudhën e kërkuar në pikën 2.3.7, ku për përmbushjen e këtij kushti operatori ekonomik ofertues duhet ta deklarojë në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 në DST, si dhe *në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit*, duhet të paraqesë dokumentacionin: kontratë të vlefshme pune dhe çertifikatë përkatëse të lëshuar nga Drejtoria MZSH/ekuivalente.

- f) Operatori ekonomik ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë (*nga Administratori i shoqërisë*) Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt i cili duhet të jetë inxhinier me përvojë pune dhe i përfshirë në licencën e shoqërisë, dhe të deklarojë se do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, *ku në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit*, për drejtuesin teknik të deklaruar, duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
- Librezë pune (përkatëse)
 - CV përkatëse
 - Kontratë noteriale pune e vlefshme (përkatëse)
 - Diplomë
- Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomik, secili operator ekonomik në bashkim, duhet të përcaktojë me anë të një deklarate, Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt në varësi të vlerës së preventivit të punimeve që ka marrë përsipër sipas përqindjes së bashkëpunimit.

Shënim: Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë vërtetësinë e deklaratës. Në rast deklarimi të rreme do të veprohet në përputhje me parashikimet e Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” të ndryshuar.

Argumentimi: AK argumenton se kërkesa për Përgjegjësin për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4; të VKM-së nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Neni 39, pika 6, gërma “c”, si dhe në mbështetje të Nenit 7 të Ligjit Nr. 10237, datë 18.02.2010, “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, i ndryshuar sipas të cilit: “1. Punëdhënësi ngarkon një ose disa punëmarrës, që të merren me çështjet e mbrojtjes, të sigurisë e shëndetit në punë dhe të parandalimit të rreziqeve profesionale në ndërmarrje/institucion”.

Theksojmë se, Autoriteti Kontraktor ka qëllim realizimin e kontratës objekt prokurimi sipas kushteve të përcaktuara në DST, duke respektuar çdo rregull lidhur me kantierin e ndërtimit si dhe me sigurinë e punonjësve gjatë ushtrimit të veprimtarisë së punës. Është e rëndësishme që punimet të realizohen brenda një kantieri të sigurt duke mbrojtur jetën e punonjësve, por dhe të kalimtarëve që mund të jenë përreth vendit të punimeve. Për sa më lart, punonjësi i cili është i çertifikuar si “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë”, nëpërmjet dijes dhe eksperiencës të fituar në këtë fushë, duhet të shmangë apo parandalojë çdo rrezik që mund të shfaqet gjatë veprimtarisë së shoqërisë dhe që mund të çënojë shëndetin apo sigurinë në punë. Në këto kushte, vendosja e këtij kriteri shërben si një garanci që Ofertuesit do të realizojnë punimet sipas standarteve ligjore në fuqi.

- a) **2.3.10 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë,** automjetet, makineritë dhe pajisjet (**sipas tabelës**) të cilat duhet të jenë në pronësi të tij ose me qira të vërtetuara këto me dokumentacionin përkatës;

Nr.	Përshkrimi i Automjetit/ Makinerisë/ Pajisjes	Sasia
1.	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës min. 20 ton	<i>jo më pak se 4 copë</i>
2.	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës 7 - 15 ton	<i>jo më pak se 2 copë</i>
4.	Autovinç/ Kamion me Vinç	<i>jo më pak se 2 copë</i>
5.	Kamionçinë me kapacitet mbajtës deri në 3.5 ton	<i>jo më pak se 2 copë</i>
6.	Rimorkiator për lëvizjen e mjeteve	<i>jo më pak se 1 copë</i>
7.	Greider	<i>jo më pak se 1 copë</i>
8.	Eskavator me goma	<i>jo më pak se 2 copë</i>
9.	Eskavator me zinxhir	<i>jo më pak se 2 copë</i>
10.	Eskavator me krahë të gjatë	<i>jo më pak se 1 copë</i>
11.	Çekic pneumatik	<i>jo më pak se 1 copë</i>
12.	Fadromë me goma	<i>jo më pak se 2 copë</i>
13.	Minieskavator	<i>jo më pak se 1 copë</i>
14.	Minifadromë	<i>jo më pak se 1 copë</i>
15.	Damper kantieri	<i>jo më pak se 2 copë</i>
16.	Damper mbi 20 ton	<i>jo më pak se 1 copë</i>
17.	Autobetoniere	<i>jo më pak se 2 copë</i>
18.	Autopompë Betoni	<i>jo më pak se 2 copë</i>
19.	Autobot uji	<i>jo më pak se 1 copë</i>
20.	Buldozier	<i>jo më pak se 1 copë</i>
21.	Rul ngjeshës gomë – cilindër	<i>jo më pak se 1 copë</i>
22.	Rul cilindër - cilindër	<i>jo më pak se 2 copë</i>
23.	Tokmak Elektrik për ngjeshje dheu	<i>jo më pak se 2 copë</i>
24.	Nivelues lazer për nivelim tubacioni	<i>jo më pak se 1 copë</i>
25.	Aparat GPS	<i>jo më pak se 1 copë</i>
26.	Betoniere 0.25 – 0.5 m ³	<i>jo më pak se 1 copë</i>
27.	Vibrator Betoni	<i>jo më pak se 1 copë</i>
28.	Makineri Prerëse Betoni	<i>jo më pak se 2 copë</i>
29.	Armaturë Kallëperi betoni	<i>jo më pak se 2000 m²</i>
30.	Pompë Uji	<i>jo më pak se 1 copë</i>
31.	Pompë drenazhimi	<i>jo më pak se 500 m²</i>
32.	Sonde shpuese	<i>jo më pak se 2 copë</i>

33.	Matrapik	<i>jo më pak se 1 copë</i>
34.	Gjenerator	<i>jo më pak se 1 copë</i>
35.	Saldatriçe	<i>jo më pak se 2 copë</i>
36.	Drage per germim ne uje	<i>jo më pak se 1 copë</i>
37.	Motosharrë për prerje bimësie	<i>jo më pak se 2 copë</i>
38.	Aparat për kthim dhe prerje hekuri (Tranxhë hekuri)	<i>jo më pak se 1 copë</i>

b) Gjithashtu në zbatim të VKM-së Nr.312, datë 05.05.2010, operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojë mjete dhe pajisje mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit, si më poshtë:

- Kokore + Jelekë fosforeshentë – *jo më pak se 50 copë*
- Komplet i ndihmës së shpejtë – *jo më pak se 5 copë*
- Fikëse zjarri të lëvizshme me kapacitet 5-7 litra – *jo më pak se 10 copë*
- Prozhektorë ndriçimi natën – *jo më pak se 5 copë*
- Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt – *jo më pak se 10 copë*

□ **Për përmbushjen e këtij kushti, operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të deklarojë sipas formës së disponimit të mjeteve/ makinerive dhe pajisjeve të kërkuara më lart, në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të shtojcës 8 në DST, dhe në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të paraqiten:**

- 1- Për mjetet që shënohen në rregjistra publike duhet të paraqitet dokument që vërteton Rregjistrimin e mjetit (*leje qarkullimi*), Çertifikatën e Kontrollit Teknik (*të vlefshme*), Siguracionin e mjetit (*të vlefshme*), Taksat e paguara, Leje e transportit (*vetëm për kamionët dhe kamionçinat*) dhe Foto e dukshme të mjetit.
- 2- Për mjetet e siguruar me qira, të paraqitet kontrata e lidhur para noterit për këtë objekt, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt e këtij prokurimi, shoqëruar me Akt - Pronësie origjinal ose fotokopje të noterizuar plus dokumentat që vërteton Rregjistrimin e mjetit (*leje qarkullimi*), Çertifikatën e Kontrollit Teknik (*të vlefshme*), Siguracionin e mjetit (*të vlefshme*), Taksat e paguara, Leje e transportit (*vetëm për kamionët dhe kamionçinat*) dhe Foto e dukshme të mjetit.
- 3- Për paisjet/ makineritë në pronësi të shoqërohen me Akt - Pronësie origjinal ose fotokopje të noterizuar (*kontrata shit-blerje, kontrata dhurimi, fatura tatimore shitje, deklaratë zhdoganimit*) dhe Foto e dukshme të pajisjes/ makinerisë (*të paktën 1*).
- 4- Për paisjet/ makineritë me qera të paraqitet kontrata e lidhur para noterit për këtë objekt, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt e këtij prokurimi, shoqëruar me Akt - Pronësie origjinal ose fotokopje të noterizuar (*kontrata shit-blerje, kontrata*

dhurimi, fatura tatimore shitje, deklaratë zhdoganimi) dhe Foto e dukshme të pajisjes/ makinerisë (të paktën 1)

5- Operatori Ekonomik duhet të paraqesë deklaratë me anë të së cilës të deklarojë vendndodhjen e mjeteve të kërkuara në procedurën e prokurimit publik si dhe te pranoje verifikimin e mjeteve dhe pajisjeve të deklaruar në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës nga Autoriteti Kontraktor.

6- Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës deklaronte se mjetet dhe pajisjet e deklaruar nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera.

Argumentimi Ligjor: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/d, 8 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Gjithashtu kriteri është vendosur referuar zerave të punimeve.

Në mbështetje të dispozitës ligjore të sipërcituar Ligjvënësi i jep të drejtën Autoritetit Kontraktor të kërkojë nga ana e Operatorëve ekonomik mjetet dhe pajisjet teknike Njësia e Prokurimit ka vlerësuar si të domosdoshëm paraqitjen e deklaratave dhe dokumentacionit përkatës në lidhje me mjetet dhe pajisjet teknike që Operatori ekonomik disponon në funksion të realizimit të kontratës objekt prokurimi.

Mjetet e mësipërme kërkohen duke u bazuar në proceset e punës, volumet e punimeve të preventivit dhe grafikut të punimeve të kryera gjatë javës ku shënohet dhe piku i punimeve dhe duke u bazuar në shpërndarjen e punimeve në objekt dhe certifikatën e kontrollit teknik të mjeteve rrugore.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

NJESIA E PROKURIMIT